

## AKT THEMELIMI

### I SHOQËRISË TREGTARE “LHYRA BALKAN ”SH.P.K ME SELI NË TIRANË

\*\*\*

Sot, më datë 30/01/2018, në Tiranë,

Z. Antonio Valente, shtetas italian, lindur Gaetana (LT), Itali, në 09/09/1961, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me karten e identitetit me nr AR9802901.

I cili ka vendosur themelimin e shoqërisë “LHYRA BALKAN” Sh.P.K, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat e mëposhtme:

#### NENI 1

SHOQËRINË TREGTARE “LHYRA BALKAN” SH.P.K, është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar . Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë dhe do të mund të vendos ose heq seli sekondare, zyra sekondare perfaqesimi dhe agjenci në shqipëri edhe jashtë shtetit.

#### NENI 2

##### Emri i shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin LHYRA BALKAN.

#### NENI 3

##### Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka për objekt - në përputhje me kërkesat ligjore - veprimtaritë e mëposhtme:

Konsulencë për ndërkombëtarizimin dhe financimin e lehtësuar.

#### NENI 4

##### Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë në adresën: Rruga “Kajo Karafili”, Hyrja 2, Ap. 5, Zona Kadastrale 8380, Tirane, Shqiperi.

#### NENI 5

##### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakut të vetëm themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën 100 (njëqind) lek, dhe është 1 (një) kuote.

Themeluesi merr në pronësi kuoten e tij në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tij.

Kontributi i ortakut themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:

Z. Antonio Valente 1 kuote , me vlerë 100 Lek, zotëron 100 % (njëqind ).

#### NENI 6

##### Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Aktivitete tregtare mbyllen në datën 31 dhjetor të çdo viti. Aktiviteti i parë tregtar do të mbylljet në datën 31 dhjetor 2018.

#### NENI 7

##### Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të vetëm ;
2. Administratorët .

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet fillimisht nga Administratori i vetem i cili zgjidhet me afat pesëvjeçar të ripërtërishëm përvèç rasteve të revokimit ose të dorëheqjes ose shkaqeve të tjera ligjore.

Administratori i Shoqërisë i cili pranon do të jetë **Z.Antonio Valente**, shtetas italian, lindur Gaetana (LT), Itali, në 09/09/1961, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me karten e identitetit me nr AR9802901.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Shoqëria është e administruar nga një administrator i vetëm, edhe jo ortak ose nga shumë administrator, edhe jo ortak, sipas asaj që është përcaktuar në aktin e emërimit.

Kur administrimi i shoqërisë i është besuar disa personave, akti i emërimit vendos në alternative që:

- a) nëse administratorët do të veprojnë në mënyrë kolegiale duke themeluar kështu këshillin e administrimit
- b) nëse administrimi është caktuar bashkarisht ose jo bashkarisht.

#### NENI 8

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### NENI 9

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

### **NENI 10**

#### **Ligji i aplikueshëm**

Veprimitaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortaku themelues dhe të legalizohet përpara noterit ditën e themelimit, sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

### **NENI 11**

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me themelimin e Shoqërisë do të zgjidhen nga Ortaku i vetëm, në rast të kundërt do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

### **NENI 12**

#### **Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi hartohet në (2) kopje në gjuhën shqipe dhe atë Italiane dhe u lexua nga Ortaku Themelues i cili e gjeti atë në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe e nënshkroi pa vërejtje.

### **ORTAKU THEMELUES**

**Z. Antonio Valente**



**ANTONIO VALENTE**